



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.97/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Tecol” sh.p.k, me numër unik identifikues ..., me seli në Pejë, Rr. “...”, ..., kundër debitorit M.P. B.I (emri tregtar N.P.T “Korabi Furniture” me numër të biznesit ...), me numër unik identifikues ..., me seli në Istog, Rr. “...”, p.n, Banjë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të datës 28.06.2022, të paraqitur ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.161/22 të datës 13.06.2022 të Përmbartuesit Zija Bala, me seli të zyrës në Pejë, me dt. 19.06.2023 jashtë seancës merr këtë:

A K T V E N D I M

1. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit të përmbartimit M.P. B.I (emri tregtar N.P.T “Korabi Furniture” me numër të biznesit ...), me numër unik identifikues ..., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.161/22 të datës 13.06.2022, të Përmbartuesit Zija Bala, me seli të zyrës në Pejë, dhe i njëjti Urdhër mbetet në fuqi në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat në cilësinë e organit përmbartues, me Urdhrin Përmbartimor P.nr.161/22 të datës 13.06.2022, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave nr.1374/21 të datës 11.05.2021, nr.162/21 të datës 22.01.2021, nr.717/20 të datës 08.05.2020, nr.201/20 të datës 28.01.2020, nr.3867/19 të datës 18.12.2019, nr.3592/19 të datës 23.11.2019, nr.2826/19 të datës 19.09.2019, nr.2774/19 të datës 16.09.2019 dhe nr.1178/19 të datës 08.05.2019, duke detyruar debitorin që t’ia paguajë kreditorit borxhin në shumë prej 23,795.18 € (njëzetë e tremijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë euro e tetëmbëdhjetë centë), me kamatë ligjore prej 8 % sipas LMD-së, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore aq sa do të krijohen konform UA-MD Nr.01/2022, në afate prej 7 ditëve nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të përmbartuesit privat mbi caktimin e përmbartimit, brenda afatit të rregullt ligjor ka ushtruar prapësim debitori i përmbartimit, duke theksuar se urdhri i lartcekur është i bazuar vetëm në dokumentet-faturat të cilat janë pjesërisht të pranuar nga debitori, dhe shuma totale e borxhit është 12,961.48 €. Tutje ka theksuar se faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri i atakuar përmbartimor nuk i përmban kushtet e kërkuara nga neni 29 të LPP-së. Po ashtu ka theksuar se arsyeja kryesore për palejueshmëri të propozimit përmbartimor rezulton nga fakti se debitori dhe kreditori kanë nënshkruar një marrëveshje për pagesën e detyrimeve, dhe shuma e paraqitur në propozimin për përmbartim nuk është reale, sepse shumica e faturave janë detyrime

të shlyera nga ana e debitorit. Pra, marrëveshja për riprogramim të borxhit e datës 0104.2022 e dëshmon shumë e saktë të detyrimit, e që dallon nga pretendimet e kreditorit. Në bazë të kësaj marrëveshje jemi darkorduar të dy palët me vullnet të plotë për mundësinë e pagesës në dy mënyra, njëra pjesë deri në muajin korrik dhe tjetra deri më së voni në muajin tetor të 2022, ndërsa kreditori ka injoruar marrëveshjen dhe pa u kryer afati përfundimtar ka paraqitur propozim për përmbarim. I ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, dhe ta shfuqizojë urdhrin përmbarimor të lartcekur si të kundërligjshëm dhe të pa bazuar.

Kreditori i përmbarimit ka parashtruar përgjigje në prapësim duke theksuar se pretendimet e debitorit lidhur me mos respektimin e marrëveshjes për riprogramim të borxhit mes palëve nuk qëndrojnë, pasi që edhe për kundër faktit se kreditori ka shprehur gatishmërinë që debitorit ti mundësoj që një pjesë të borxhit ta paguaj me këste sipas planit të paraparë me marrëveshjen në fjalë, debitorin nuk e ka respektuar, pasi që duke i'u referuar marrëveshjes në fjalë debitorin brenda afatit kohor nga data 15 Prill deri me datën 15 Maj 2022 ka qenë i obliguar ta realizoj pagesën e këstit të parë në shumë prej 5,000.00 € (pesëmijë euro), pagesë e cila nuk është realizuar. Tutje ka theksuar se urdhri i lartcekur përmbarimor është caktuar në bazë të dokumentit të besueshëm i cili i përmban të gjitha elementet e nevojshme të parapara me Ligjin e Procedurës Përmbarimore, dhe si i tillë nuk përmban asnjë të metë juridike dhe se për këtë arsye i njëjti i ka të gjitha tiparet e dokumentit të përmbarueshëm të parapara me nenin 29 par.1 pika 1.3 dhe par.3 të LPP-së. Po ashtu ka theksuar se është evidente dhe vërehet qarë se prapësimi i ushtruar nga ana e debitorit ka për qëllim vetëm prolongimin e lëndës, ngase prapësimi në fjalë është i pa bazuar pasi që nuk mbështetet në asnjë provë që parashihet në nenin 69 par.5 dhe 6 të LPP-së, si dhe mungojnë shkaqet e prapësimit të parapara me nenin 71 të po të njëjtit Ligj. I ka propozuar gjykatës të të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.161/22, si dhe të obligohet debitorit ta paguaj pjesën e mbetur të borxhit kryesor, shpenzimet e kreditorit si dhe shpenzimet-tarifën e përmbaruesit privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit të përmbarimit dhe analizimit të shkresave në lëndë, ka gjetur se prapësimi i debitorit të përmbarimit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Në shkresat e lëndës është evidentuar se Kreditori i përmbarimit i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm / Faturat nr.1374/21 të datës 11.05.2021, nr.162/21 të datës 22.01.2021, nr.717/20 të datës 08.05.2020, nr.201/20 të datës 28.01.2020, nr.3867/19 të datës 18.12.2019, nr.3592/19 të datës 23.11.2019, nr.2826/19 të datës 19.09.2019, nr.2774/19 të datës 16.09.2019 dhe nr.1178/19 të datës 08.05.2019, për lartësinë e shumës së borxhit 23,795.18 €, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitorin, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*; Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i*

bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Meqenëse në këtë çështje përmbartimore gjykata vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbartues sipas dispozitave të zbatuara ligjore, nga sa u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.97/2023, dt.19.06.2023

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.